



## UNIVERSITETI "KADRI ZEQA" UNIVERSITY

Zija Shemsiu, 60000, Gjilan, Kosovë  
www.uni-gjilan.net tel: 0280-390-112

### SYLLABUS

Lënda: Financa

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti ekonomik, Departamenti: banka dhe financa
Titulli i lëndës:	Financa
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	obligative
Viti i studimeve:	viti i II-të, semestri i III-të
Numri i orëve në javë:	2 + 1
Vlera në kredi – ECTS:	6
Koha / lokacioni:	Ligjërata: e shtune Ushtrime: Asistent: Arben Sahiti
Mësimdhënësi i lëndës:	Lutfi Zharku
Detajet kontaktuese:	<a href="mailto:lutfi.zharku@hotmail.com">lutfi.zharku@hotmail.com</a>
<b>Përshkrimi i lëndës</b>	Lënda u ofron studentëve njohuritë themelore mbi teorinë, metodat dhe problemet e financave bashkëkohore, krijimin dhe menaxhimin e parasë dhe asetëve të tjera financiare midis firmave dhe tregjeve financiare me theks të veçantë në instrumentet e tregut të parasë dhe kapitalit. Studentët gjithashtu do të fitojnë njohuri se si firmat krijojnë dhe menaxhojnë në mënyrë efikente asetet e tyre financiare.
<b>Qëllimet e lëndës:</b>	Qëllimi kryesor është që studentët të jenë në gjendje të analizojnë vendimet kritike nga prespektiva financiare. Qëllimi i lëndës gjithashtu është të ofrojë një perspektivë të gjerë se si teoria dhe praktika financiare ndërveprojnë në jetën e vërtetë dhe përgatitjen e studentëve për karrierë të suksesshme në industrinë financiare. Qëllimet kryesor të lëndës janë: 1. Të kuptojnë se si të menaxhojmë burimet financiare; 2. Të kuptojnë botën e financave. Çdokush i përfshirë në menaxhimin e një biznesit duhet të ketë të paktën njohuri bazë në fushën e financave; 3. Të kuptojnë konceptet themelore financiare si vlerën në kohë të parasë, vlerësimin e asetëve, rrezikun dhe kthimin, buxhetimin e kapitalit, etj.
<b>Rezultatet e pritura të nxënies:</b>	Me përfundimin e kësaj lënde studentët do të jenë në gjendje: <ul style="list-style-type: none"><li>• Të kuptojnë parimet themelore të financave bashkëkohore;</li><li>• Të kuptojnë se si të krijojnë dhe të menaxhojnë në mënyrë</li></ul>

	<p>efiçente asetet e tyre financiare në tregun financiar;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Të kuptojnë rolin dhe rëndësinë e tregut financiar;</li> <li>• Të kuptojnë se si ti menaxhojnë rreziqet e ndryshme: si rrezikun e kursit të këmbimit, të normës së kamatës, të inflacionit;</li> <li>• Të jenë në gjendje që njohuritë e fituara t'i aplikojnë në afarizmin e ndërmarreve;</li> </ul>		
<b>Kontributi në ngarkesën e studentit (duhet të korrespondojë me rezultatet e të nxënit të studentit)</b>			
<b>Aktiviteti</b>	<b>Orë</b>	<b>Ditë/javë</b>	<b>Gjithsej</b>
Ligjërata	2	15	22.5
Ushtrime teorike/laboratorike	1	15	11.25
Kontaktet me mesimdhënësin/konsultimet	10 min	15	2.5
Kollokfiime,seminare	25	1	25
Detyra të shtëpisë	1	15	15
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	4	15	60
Përgatitja përfundimtare për provim	15	1	15
Koha e kaluar në vlerësim (teste, provim final)	1	2	2
Projektet, seminare, prezantimet ,etj	30 min	1	0.5
<b>Totali</b>			<b>150 orë= 6 ECTS</b> (153.75:25=6.15)
<b>Metodologjia e mesimdhënies:</b>	<p>Mësimdhënia në këtë lëndë është e përqendruar në ligjërata dhe ushtrimin e detyrave në grup dhe në shtëpi. Në ligjërata përdoret metoda e shpjegimit dhe metoda interaktive. Marrja e shembujve dhe analiza e tyre do të zhvillohet në grup në klasë gjatë ushtrimeve. Në fund të ligjëratave studentët marrin detyra që duhet t'i bëjnë në shtëpi dhe t'i diskutojnë në orën vijuese bashkë me asistentin. Ligjëratat dhe ushtrimet përqendrohen në dy aspekte: 1. studentët ta përvetësojnë njohuri të përgjithshme 2. studentët të përvetësojnë aftësinë që teoritë e mësuara t'i aplikojnë në praktikë.</p>		
<b>Metodat e vlerësimit:</b>	<p>Testi i parë: 1-30 pikë  Testi i dytë: 1-30 pikë  Seminari: 1-10 pikë  Vijimi i rregullt dhe aktiviteti në klasë: 1-10 pikë  Provimi përfundimtar: 1-20 pikë  Totali: 100 pikë.</p> <p>Vlerat e pikëve:  Provimi ka 100 pikë.  50-60 = 6; 61-70 = 7; 71-80 = 8; 81-90= 9; 91-100 = 10  Pikët nën 50 nuk mbërrijnë notën kaluese.</p>		

<b>Literatura</b>	
<b>Literatura bazë:</b>	1. Prof. Dr. Sabahudin Komoni “Financa”, Prishtine, 2012 2. Herbert B. Mayo “Bazat e financës”, UET Press, Tiranë, 2012
<b>Literatura shitesë:</b>	Zvi Bodie & Robert C. Merton “Finance”, Prentica Hall, New Jersey, 1998
<b>Plani i dizajnuar i mësim:</b>	
<b>Java</b>	<b>Ligjërata që do të zhvillohet</b>
<i>Java e parë:</i>	Hyrje ne Financa dhe paraja
<i>Java e dytë:</i>	Sistemet monetare
<i>Java e tretë:</i>	Qarkullimi i parase dhe masa monetare
<i>Java e katërt:</i>	Vlera kohore e parase, risku dhe kthimi
<i>Java e pestë:</i>	Sistemi kreditor
<i>Java e gjashtë:</i>	Sistemi bankar
<i>Java e shtatë:</i>	Test me shkrim
<i>Java e tetë:</i>	Punet (operacionet) bankare
<i>Java e nëntë:</i>	Potenciali kreditor i bankave
<i>Java e dhjetë:</i>	Multiplikacioni kreditor dhe monetar
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Paraja primare dhe politika monetare-kreditore
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Inflacioni dhe deflacioni, devalvimi dhe revalvimi
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Paraja ne qarkullimin e pgesave nderkombetare
<i>Java e katërbëdhjetë:</i>	Sistemi monetar nderkombetar
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Test me shkrim

<b>Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:</b>
Studenti është i obliguar të vijojë ligjërata dhe ushtrime. Plagjiatura dhe kopjimi në provime janë të dënueshme sipas statutit dhe rregulloreve të tjera te universitetit. Kodi e mirësjelljes vlen si për studentët ashtu edhe për mësimdhënësit.